



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIAR TË KOMUNËS SË KLLOKOTIT PËR VITIN 2019

Prishtinë, korrik 2020

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë llogaridhënien e institucioneve publike, duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur për opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Klllokotit në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Emine Fazliu, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga udhëheqësja e ekipit Svetlana Perovic dhe Agim Sogojeva, anëtar i ekipit, nën menaxhimin e Drejtorit të Departamentit të Auditimit, Luljeta Morina.


TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit.....	5
1 Opinion i Auditimit mbi Pasqyrat Vjetore Financiare	6
2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli.....	8
3 Progres në zbatimin e rekomandimeve	23
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja	31
Shtojca II: Letër konfirmimi.....	34

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i komunës së Klllokotit për vitin 2019, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2019 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA).

Auditimi është fokusuar në:



Konkluzionet

Pasqyrat Financiare Vjetore ishin përgatitur sipas kornizës për raportim financiar, përveç klasifikimit të gabuar të shpenzimeve që ndikuan në theksimin e çështjes.

Sa i përket menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, komuna duhet të ndërmarrë veprime shtesë për t'i përmirësuar ato. Dobësi të konsiderueshme janë vërejtur në fusha të rëndësishme financiare si: të hyrat, shpenzimet për paga dhe mëditje, detyrimet, të arkëtueshmet, si dhe pasuritë jo-financiare dhe auditimi i brendshëm. Kjo pasqyron mungesën e mbikëqyrjes së duhur nga menaxhmenti në këto fusha.

Zbatimi i rekomandimeve të vitit të kaluar nuk është duke u adresuar në nivelin e duhur nga menaxhmenti i komunës. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2019, nga gjithsej 19 rekomandime të dhëna për vitin 2018, janë zbatuar pesë rekomandime, një është në proces, tetë nuk janë adresuar ende, ndërsa pesë janë mbyllur.

Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm¹

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Më gjerësisht shih kapitullin¹ të këtij raporti.

Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2019

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna. ZKA vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të Komunës gjatë procesit të auditimit.

¹ Shtojca I shpjegon llojet e mendimeve sipas SNISA.

Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase.
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e komunës, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përmbledhje të detajuar të gjetjeve tona të auditimit dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimi. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund të gjenden në Shtojcën II.

1 Opinion i Auditimit mbi Pasqyrat Vjetore Financiare

Ne kemi kryer auditimin Pasqyrave Financiare Vjetore të Komunës së Klllokotit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2019, në përputhje me Ligjin e ZKA dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Ekzaminimet e auditimit janë kryer për të mundësuar dhënien e opinionit për PFV-të, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme dhe pasqyrën e ekzekutimit e buxhetit, të shpalosura në detaje.

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me SNISA-t 10 dhe 30, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga Komuna. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin.

Theksimi i çështjes

Komuna gjatë vitit 2019 kishte paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë prej 60,261€ në kategori ekonomike jo adekuate. Nga kategoria e investimeve kapitale janë paguar 8,422€ për shpenzime të cilat i takojnë kategorisë paga dhe mëditje si dhe 51,839€ ishin paguar nga investimet kapitale për shpenzime të cilat i takojnë kategorisë së mallrave dhe shërbimeve. Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit. Opinioni ynë nuk është modifikuar me këtë çështje.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV

Kryetari i Komunës, është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Gjithashtu, menaxhmenti është përgjegjës për kontrollet e brendshme që menaxhmenti i konsideron të domosdoshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, qofshin ato të shkaktuara nga mashtrimi ose gabimi. Kjo përfshin zbatimin ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë (i ndryshuar dhe plotësuar) dhe Rregulloren Nr. 01/2017 për Pasqyrën Vjetore Financiare të Organizatës Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV-të në bazë të auditimit të kryer, në përputhje me SNISA-t. Këto standarde kërkojnë që të marrim siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keqdeklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

Ne komunikojmë me menaxhmentin e entitetit të audituar në lidhje me fushëveprimin, kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Raporti i auditimit publikohet në webfaqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë në sistemet e të ardhurave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Auditimi u përqendrua në menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit si dhe burimet njerëzore, pasuria, detyrimet dhe funksionet e auditimit të brendshëm.

Konkluzioni për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin

Gjatë vitit 2019, komuna kishte realizuar 99% të buxhetit final, që nënkupton një realizim të mirë në nivel të përgjithshëm. Në kontekst të sistemeve financiare kontrollet mbi të hyrat si dhe mbi shpenzimet kërkojnë përmirësime të mëtutjeshëm si dhe veprime shtesë.

Sa i përket fushës së shpenzimeve, në kategorinë e pagave dhe mëditjeve duhet bërë korrigjimi i koeficienteve të pasaktë të punëtorëve, në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve angazhimi i stafit përmes marrëveshjeve të shërbimeve të veçanta, po ashtu kontrollet duhet të shtohen edhe tek shpenzimet e parave të gatshme, menaxhimin e detyrimeve, menaxhimin e pasurisë, si dhe zbatimin e funksionit të kontrollit të brendshëm. Po ashtu, duhet të shtohen kontrollet sa i përket klasifikimit të shpenzimeve në kategoritë adekuate si dhe në uljen e pagesave përmes vendimeve gjyqësore..

Gjithashtu, kontrollet në planifikimin dhe mbledhjen e të ardhurave në tërësi nuk janë të përshtatshme dhe nuk zbatohen në mënyrë efektive, veçanërisht në mbledhjen e të ardhurave nga ofrimi i shërbimeve publike për mbledhjen e mbeturinave. Në këtë fushë, kërkohet zhvillim i mëtutjeshëm i kornizës ligjore me miratimin e rregulloreve të brendshme, si dhe përmirësimi i mbajtjes së regjistrave adekuat për pagesat e shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave, sepse regjistrimet mbi të ardhurat dhe arkëtimet nga ky shërbim nuk gjenerojnë të dhëna të sakta. Gjithashtu, ri-anketimi i taksapaguesve të pasurive mbetet jashtë kornizës ligjore.

2.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2019 Realizimi	2019 % Realizimi	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Burimet e Fondeve:	1,241,812	1,299,140	1,289,491	99 %	1,327,317	908,325
Granti i Qeverisë - Buxheti	1,104,628	1,140,250	1,137,347	100 %	1,051,964	760,323
Të bartura nga viti paraprak ³		21,363	21,356	100 %	150,800	92,690
Të hyrat vetanake ⁴	131,050	131,050	130,788	100 %	124,553	29,273
Huamarrja	6,134	6,134	0	0	0	0
Donacionet e brendshme	0	0	0	0	0	26,039
Donacionet e jashtme	0	343	0	0	0	0

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 57,328€. Kjo rritje është rezultat i të hyrave vetjake të pashpenzuara të transferuara në shumën prej 21,363€ me vendimin Nr. 512/2 të 02.04.2019 dhe nga Granti Qeveritar për 35,965€.

Gjatë vitit 2019, komuna ka shpenzuar 99% të buxhetit final ose 1,289,491€, me një përmirësim prej 1% në krahasim me vitin 2018.

² Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

³ Të hyrat vetanake të komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

⁴ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e buxhetit vetanak.

Tabela 2. Shpenzimi i fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2019 Realizimi	2019 % Realizimi	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	1,241,812	1,299,140	1,289,491	99 %	1,327,317	908,325
Pagat dhe Mëditjet	740,000	775,622	775,622	100 %	702,655	674,430
Mallrat dhe Shërbimet	127,961	132,303	125,695	95 %	131,746	119,065
Shërbimet komunale	45,000	45,270	45,261	100 %	25,745	21,949
Subvencionet dhe Transferet	6,644	12,644	12,642	100 %	8,764	27,874
Investimet Kapitale	322,207	333,301	330,271	99 %	458,407	65,007

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore:

- Buxheti final në kategorinë e pagave dhe mëditjeve në raport me buxhetin fillestar ishte rritur prej 35,622€ nga Granti i Qeverisë. Buxheti final ishte shpenzua 100%;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 4,342€ me bartjen e të hyrave vetjake të pashpenzuara nga viti 2018 në shumën prej 4,000€ dhe bartjen e donacioneve në vlerë prej 343€. Buxheti final ishte shpenzuar 95% për shkak të mos përdorimit të fondeve nga huamarrja;
- Buxheti final për shërbimet komunale dhe ai për subvencione ishin realizuar 100%;
- Buxheti final për investime kapitale në krahasim me buxhetin fillestar është rritur për 11,093€ duke bartur të hyrat vetanake të pashpenzuara nga viti 2018, ndërsa niveli i shpenzimeve ishte 99%. Sipas Ligjit për Buxhetin Nr. 06 / L-133, në Tabelën 4.2 Financimi i Investimeve Kapitale 2019-2021, janë të destinuara fondet për financimin e pesë projekteve kapitale.

Çështja B1 – Klasifikim jo adekuat i shpenzimeve dhe shpenzimet shtesë**Gjetja**

Sipas Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF “Mbi shpenzimin e parasë publike” shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël, po ashtu me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë.

Siç kemi paraqitur te theksimi i çështjes, komuna gjatë vitit 2019 kishte paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë prej 60,261€⁵ në kategori ekonomike jo adekuate. Nga kategoria e investimeve kapitale janë paguar 8,422€ për shpenzime të cilat i takojnë kategorisë paga dhe mëditje si dhe 51,839€ ishin paguar nga investimet kapitale për shpenzime të cilat i takojnë kategorisë së mallrave dhe shërbimeve. Këto pagesa janë si në vijim:

- Gjykata Themelore në Gjiilan - dega në Viti ka sjellë Aktgjykimin nr. 171/14, me datën 19.12.2018, i cili detyron të pandehurin (Komunën) të paguajë të ardhurat mujore të paditësit (punonjës arsimit), në vlerë prej 108€, nga 10.2.2014 deri më 31.08.2014, duke llogaritur interesin mujor prej 8% nga dita e ngritjes së padisë më 19.05.2014 deri në pagesën përfundimtare. Më 22 tetor 2019, komuna pagoi 1,042€ në emër të pagave nga kategoria e investimeve kapitale nga kodi ekonomik 34000 (vendimet gjyqësore), duke bërë kështu keq klasifikimin e shpenzimit. Shuma prej 283€ ishte paguar në emër të interesit;
- Gjykata Themelore në Gjiilan, Dega në Viti, ka sjellë Aktgjykimin nr. 168/14, me datën 08.10.2018, e cila e detyron të pandehurin (Komunën) ta kthejë paditësen në punë dhe të paguajë të ardhurat e saj personale të papaguara në shumën prej 191€, me interes prej 8%. Me 23 Shtator 2019, komuna paguan 1,740€ në emër të pagave nga kategoria e investimeve kapitale nga kodi ekonomik 34000 (vendimet gjyqësore), duke bërë kështu keq klasifikimin e kostove. Shuma prej 473€ është paguar në emër të interesit;
- Gjykata Themelore në Gjiilan dega në Viti, ka sjellë Aktgjykimin nr. 83/2019, më 26.04.2019, e cila detyron të pandehurin (Komuna) të paguajë të ardhurat bruto mujore të paditësit, në vlerë prej 182€ për periudhën nga 10.02.2014 deri më 31.08.2014 me një normë mujore interesi prej 8% nga 30.03.2015 si dhe shumën 400€ për shpenzimet e procedurës. Më 08.08.2019, komuna ka paguar 2,366€ në emër të pagave nga kategoria e investimeve kapitale nga kodi ekonomik 34000 (vendimet gjyqësore), duke bërë kështu keq klasifikimin e

⁵ Borxhi kryesor ishte 60,261€ ndërsa 1,792€ janë për shpenzime procedurale të gjykatës/përmbarimit

shpenzimeve. Shuma prej 676€ është paguar në emër të interesit, ndërsa shuma prej 400€ ende nuk është paguar;

- Bazuar në Aktvendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës (KPMSHCK) të lëshuar më 18 janar 2019, Komuna e Kllokot ishte e detyruar të kthejë kreditorin ekzekutiv në pozitën e Zyrtarit të Kthimit dhe të paguajë detyrimet mbetura të të ardhurave personale. Komuna nuk e respektoi vendimin e KPMSHCK dhe Gjykata Themelore në Gjilan - dega në Viti, lëshoi një urdhër për ekzekutim më 25.03.2019. Komuna nuk e ka ekzekutuar këtë vendim gjyqësor, pas së cilës Thesari, sipas nenit 40 të LMFP-së nr. 03 / L-048 ka bërë një pagesë në shumë prej 3,274€ nga kategoria e investimeve kapitale në emër të pagave dhe medijëve. Në kuadër të kësaj shume, vlera prej 117€ është paguar si kamatë;
- Më 3 korrik 2018, gjykata mori një vendim, bazuar në një marrëveshje gjyqësore midis Komunës dhe qiradhënësit, i cili paditi Komunën Kllokot për mospagim të borxheve të qirasë për ndërtesën e Komunës në periudhën nga 30.09.2010 deri në 20.03.2017. Si pjesë e shlyerjes, është dakorduar pagesa në shumën totale prej 85,900€, e cila do të zbatohet në vitin 2019 në katër këste, duke filluar në shkurt 2019. Gjatë vitit 2018, komuna ka paguar 15,099€ nga fondi i investimeve kapitale, ndërsa në vitin 2019 është paguar shuma totale nga 51,838€ në emër të qirasë (kategoria e mallrave dhe shërbimeve) nga kategoria e investimeve kapitale nga kodi ekonomik 34000 (vendimet gjyqësore), duke keq klasifikuar kështu kostot. Ky është rezultat i planifikimit të dobët dhe të pabazuar për pagesën e detyrimeve kontraktuale.

Duke pasur parasysh natyrën e çështjeve gjyqësore, është e pamundur të parashikohen me saktësi absolute kontestet dhe kostot që do të dalin prej tyre. Sidoqoftë, është e mundur të sigurohet në një mase të caktua të parashikohet një shumë indikative që mund të shpenzohet për këto qëllime.

Ndikimi

Mos planifikimi adekuat i buxhetit dhe realizimi e tij i cili nuk është në pajtim me Ligjin për Buxhet dhe LMFP do të rezultojë në mos arritjen e objektivave të komunës, duke mos ofruar shërbime dhe infrastrukturë të të mirë për qytetarët. Raportimi jo i drejtë i të dhënave për klasifikimin e shpenzimeve, çorienton shfrytëzuesit e këtyre informatave të prezantuar gabimisht në PFV apo ndikon vendimmarrjen e menaxhmentit.

Rekomandimi B1 Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që kërkesat të planifikohen dhe kategorizohen sipas ndarjes adekuate të buxhetit. Nëse projeksionet e buxhetuara me ligj të buxhetit nuk përkojnë me natyrën e shpenzimit dhe kërkesat e komunës, duhet të bëhet ridestিনি i mjeteve me qëllim të sigurimit të fondeve për pagesën

e rregullt të shpenzimeve. Kjo duhet të reflektoj në përpjekjen për buxhetimin e kërkesave në kategoritë përkatëse ekonomike dhe fuqizimin e kontrollit për pagesën, evidentimin dhe prezantimin e drejt të shpenzimeve publike në PFV.

2.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga Komuna e Klllokotit në vitin 2019 ishin në vlerë prej 163,116€. Këto të hyra janë nga tatimi në pronë, tarifatat biznesore, të hyrat nga qiraja etj.

Komuna ka pranuar të ardhura indirekte nga niveli qendror në shumë prej 7,760€ (gjobat policore).

Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Pranimet	2019 % Pranimet	2018 Pranimet	2017 Pranimet
Të ardhurat	131,050	131,050	163,116	124%	133,635	111,605

Nga shuma e përgjithshme e të hyrave të arkëtuara, komuna gjatë vitit 2019 ka shpenzuar 130,788€. Të hyrat vetjake në një shumë prej 40,095€ nga viti 2018 dhe 2019 janë bartur për tu shpenzuar në vitin 2020.

Çështja A1 – Planifikimi i dobët i të hyrave vetjake

Gjetja

Në buxhetin për vitin 2019 në Tabelën 4.3 Plani afatmesëm i të ardhurave totale të buxhetit komunal, janë planifikuar të hyrat vetjake në vlerë prej 131,050€. Të hyrat u grumbulluan në vlerë prej 163,116€, ose 24% më shumë se sa ishte planifikuar. Kjo ndodhi për shkak të planifikimit të dobët.

Tatimi në pronë është grumbulluar në shumë prej 83,989€, që është 2,009€ më shumë se sa të ardhurat e planifikuara (81,980€, nga të cilat tatimi për tokë është 24,840€ dhe taksa mbi pronën 57,140€), megjithëse komuna nuk ka realizuar të ardhura nga tatimi në tokë;

Taksat komunale janë grumbulluar në shumë prej 51,467€, ose 27,397€ më shumë se sa ishte planifikuar (24,840€), për shkak të planifikimit të gabuar të të ardhurave nga tarifatat e regjistrimit të automjeteve, shuma e planifikuar e të cilave është 2,500€ ndërsa shuma e mbledhur ishte prej 7,656€, tarifa nga licencat për ndërtim, shuma e planifikuar e të cilave është 8,000€ ndërsa është realizuar shuma 9,121€, si dhe të ardhura që nuk janë planifikuar në shumë prej 21,120€ nga dokumentet zyrtare (mbledhja e sigurimeve, ndërrimi i destinimit të tokës);

Të ardhurat nga qiraja e hapësirave publike ishin në shumë prej 27,660€, që është 2,660€ më shumë sesa ishte planifikuar (25,000€) për shkak të mbledhjes së llogarive të arkëtueshme nga viti 2018.

Për devijimet në pozicione të caktuara ku ekzekutimi është më i lartë në lidhje me shumën e aprovuar nga buxheti janë bërë rialokime.

Ndikimi Planifikimi i të hyrave është i nënvlerësuar dhe mund të ndikojë në planifikimin të dobët të projekteve apo arritjes së objektivave komunale bazuar në fondet që komuna detyrohet ti bart për tu shpenzuar në vitin vijues.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të sigurojë që është realizuar planifikimi objektiv për mbledhjen e të hyrave vetjake bazuar në një analizë të mirëfilltë paraprake.

Çështja C1 – Dobësitë në menaxhimin e të hyrave nga shërbimet për grumbullimin dhe deponimin e mbeturinave

Gjetja Në bazë të ligjit nr. 04/L-060 për mbeturinat, neni 15, pika 1.8. Komuna përcakton tarifat dhe mënyrën e pagesës së mjeteve financiare për shërbimet komunale.

Më 29.01.2018, Kuvendi Komunal miratoi një vendim të ri për pagesën për ofrimin e shërbimeve në mbledhjen dhe deponimin e mbeturinave, i cili zvogëloi shumën e mëparshme prej pesë (5) euro në baza mujore në tre (3) euro për amvisëri. Mirëpo, vendimi në fjalë nuk përcakton llojin, shumën (personat juridik), lehtësimet, afatet dhe mënyrën e pagesës për këtë shërbim për personat fizikë dhe juridikë.

Kuvendi Komunal miratoi vendimin për pagesën për kontejnerë për personat juridikë Nr. 1548/2, më 04.12.2019, vlefshmëria e të cilit u kërkuar nga MAPL dhe u përçoll për shqyrtim në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë. Vendimi Nr. 7167-2/19 i dt. 03.01.2020 nuk u konfirmua, për shkaqe administrative (vonesa në dorëzim e këtij vendimi, brenda afatit ligjor).

Ndikimi Mos konfirmimi i vendimit mund të çojë në pagesë të padrejtë për shërbime, për shkak të mos dallimit në shumën e kompensimit midis personave fizik dhe personave juridikë.

Rekomandimi C1 Kryetari duhet të iniciojë ri-miratimin e Rregullores për pagesën e shërbimeve në mbledhjen dhe deponimin e mbeturinave, në përputhje me Ligjin Nr. 04 / L-060 për mbeturinat.

Çështja A2 - Verifikimi i 1/5 të pronës së tatueshme nuk është arritur

Gjetja Komuna nuk ka arritur të verifikojë 1/5⁶ e pasurive të paluajtshme në përputhje me Ligjin për tatimin e pasurisë së patundshme nr. 03 / L-204 me ndryshime dhe plotësime. Kjo ka ndodhë për shkak se Komuna nuk kishte angazhuar staf si anketuesve dhe nuk ishte e pajisur me pajisjet e nevojshme (iPad), që nevojiten për regjistrimin e pasurisë në zonat e përcaktuara me Rregulloren për tatimin e pasurive të patundshme me Nr. 11178/2 për vitin 2019, miratuar me 30.11.2019.

Ndikimi Mosarritja e verifikimit të 1/5 të pronave mund të çojë në informata jo të plota mbi pasurinë aktuale të tatueshme, me ndikimin e mundshëm që të ardhurat e vlerësuara të tatimit në pronë të zvogëlohen.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të analizojë arsyet dhe pengesat për shkak të cilave nuk janë zbatuar kërkesat ligjore në këtë fushë dhe të ndërmarrë veprime shtesë me qëllim të verifikimit të pronës komunale në vitin e ardhshëm në përputhje me ligjin.

2.1.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për pagat dhe mëditjet ishte 775,622€. Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 124, ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 147⁷, nga të cilët 95 ishin me orar të plotë, ndërsa nga 52 të angazhuar në arsim, 20 ishin me kohë të plotë dhe 32 me kohë të pjesshme. Gjatë vitit 2019 janë punësuar dy punonjës të rinj, një zyrtar shëndetësor dhe një zyrtar personeli. Ne testuam 83 mostra për teste substanciale si dhe 10 mostra për teste pajtueshmërie.

Çështja B2 - Koeficientet e gabuar për llogaritjen e pagave në arsim

Gjetja Të gjithë arsimtarët e punësuar në departamentin e arsimit, pavarësisht nëse ata punojnë në arsimin parashkollor, fillor ose të mesëm, marrin paga të llogaritura sipas koeficientit A-382, i cili deri në vitin 2011 ishte në përdorim ekskluzivisht për mësuesit e arsimit fillor. Menaxhmenti i Komunës ka vendosur kontrole të brendshme për të reaguar ndaj parregullsive, por gjatë vitit 2019 vetëm për shtatë punëtorë janë bërë ndryshime.

Ndikimi Mos përditësimi i koeficientëve dhe kontratave në përputhje me ndryshimet ligjore, rezulton në pagesa më të ulëta në krahasim me aprovimet ligjore.

Rekomandimi B2 Komuna duhet të urdhërojë ndryshime në koeficientet dhe kontratat për

⁶ Gjatë viti 2019 Komuna nuk kishte verifikuar asnjë pronë.

⁷ Nuk përfshihen këshilltaret komunal.

të gjithë punonjësit e departamentit të arsimit në përputhje me normën.

2.1.3 Mallrat dhe shërbimet

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2019 ishte 132,303€, i cili ishte shpenzuar 125,695€. Këto shpenzime kryesisht kanë të bëjnë me sigurimin e objekteve, shpenzimet kontraktuese tjera, shpenzime të bazuara në vendimet gjyqësore, shpenzime të derivateve, energjisë elektrike dhe telefonisë. Ne kemi testuar 19 mostra për teste thelbësore në vlerë prej 24,078€ si dhe 5 mostra për teste pajtueshmërie. Gjithashtu, janë trajtuar të gjitha kontratat për shërbime të veçanta.

Çështja B3 - Mangësi në angazhimin e stafit me Marrëveshjeve për shërbime të veçanta

Gjetja

Në përputhje me nenin 12, pikën 4 të LSHC nr. 03 / L-149, emërimet me një afat të caktuar për një periudhë më të shkurtër se gjashtë muaj bëhen në bazë të kontratave të quajtura "Marrëveshje për shërbime të veçanta", të cilat i nënshtrohen Ligjit për detyrimet dhe për të cilat zbatohet procedura e thjeshtuar e punës. Angazhime të tilla lejohen vetëm për punë specifike dhe në rrethana të veçanta dhe të paparashikuara.

Komuna kishte angazhuar 21⁸ punëtorë përmes Marrëveshjeve për Shërbimeve Speciale (MSHV) për të cilat nuk ka zhvilluar procedura të thjeshtuara të punësimit. Shuma totale e paguar në emër të këtyre kontratave është 12,764€. Për më tepër, Komuna ka kontrata me shtatë⁹ punëtorët e punësuar në bazë të MSHV, të cilat nuk ishin paguar gjatë vitit 2019.

Pozita e menaxherit të prokurimit është e mbuluar me kontratë për një periudhë prej tetë muajsh, ndërsa pozita e këshilltarit të Kryetarit të Komunës është i mbuluar me kontratë për një periudhë prej 12 muajsh gjatë vitit 2019, që do të thotë se angazhimi i tyre ishte mbi gjashtë muaj.

Arsyeja e aplikimit të kësaj forme të punësimit të punëtorëve ishte mosmiratimi i kërkesave për vende pune shitesë përmes Ligjit për Buxhet, si dhe për shkak të nevojës për të punësuar punëtorë për të kryer punë gjatë një periudhe të caktuar gjatë vitit.

Ndikimi

Mbulimi i pozicioneve përmes MSHV për pozicione të rregullta pa procedura të thjeshtuara kufizon konkurrencën dhe si pasojë mund të ketë punësimin e personelit me kualifikime të ulëta si dhe cilësinë e dobët të

⁸ Në 11 raste angazhimi i tyre ishte për pozitat e punëtorëve teknikë (pastruesit), dy raste për pozicionet e këshilltarëve, dhe për postet e rregullta (zyrtari buxhetor, inspektori i ndërtimit, zyrtari bujqësor, zyrtari i informacionit dy pozicione, menaxheri i prokurimit, siguri, zyrtari për kujdesin shëndetësor.

⁹ Punonjës të angazhuar dhe për të cilët komuna nuk ka bërë pagesa gjatë vitit 2019 - çështje e adresuar në kapitullin e Detyrimeve

shërbimeve të pranuar.

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të sigurojë që kërkesat për vende pune të rregullta dhe afatgjate, adresohen në MF përmes planifikimit adekuat të buxhetit, duke siguruar që angazhimi të bëhet në përputhje me kërkesat ligjore përmes një procesi konkurrues dhe transparent. Po ashtu, kryetari duhet të sigurojë se punonjësit me kontrata për shërbime të veçanta do të angazhohen vetëm në rastet kur ka kërkesa specifike duke respektuar kërkesat ligjore gjatë anazhimit të tyre.

2.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere në vitin 2019 ishte 12,644€, nga të cilat 12,642€ ishin shpenzuar. Këto kosto kanë të bëjnë me subvencione për subjektet jopublike, në kuadër të shëndetësisë dhe mirëqenies sociale. Ne testuam 5 mostra për teste substanciale në shumën prej 1,574€ si dhe 5 mostra për teste pajtueshmërie.

2.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale në vitin 2019 ishte 333,301€, nga të cilat 330,271€ ishin shpenzuar. Këto shpenzime kanë të bëjnë me pagesa në emër të vendimeve gjyqësore, ndërtimin e rrugëve lokale dhe trotuareve, rindërtimin dhe zgjerimin e ndriçimit publik. Ne testuam 29 mostra për teste substanciale në shumën prej 330,271€ si dhe 5 mostra për teste pajtueshmërie. Rekomandimet në lidhje me shpenzimet e investimeve kapitale mund të gjenden në çështjen B1.

2.2 Pasuria kapitale dhe jo-kapitale

Vlera e prezantuar në PVF të pasurive kapitale është 1,361,500€, ndërsa vlera e pasurive jo-kapitale dhe stokeve nuk është prezantuar në PFV. Ne kemi testuar 53 mostra për teste substanciale, nga të cilat investimet kapitale gjatë vitit 2019 ishin në vlerë 270,010€¹⁰, si dhe asete të paregjistruara të identifikuara gjatë auditimit të vitit 2018, si dhe 10 mostra për teste pajtueshmërie.

Çështja B4 – Dobësitë në menaxhimin e pasurive

Gjetja Kemi kontrolluar nëse procesi i regjistrimit dhe mënyra e mbajtjes së regjistrave është në përputhje me kërkesat e Rregullores së MF nr. 02/2013 për menaxhimin e mjeteve jo-financiare të organizatave buxhetore.

Gjatë auditimit kemi vërejtur që komuna ka treguar dobësi në

¹⁰ Kostot totale për investime kapitale gjatë vitit 2019 arritën në 330,271€, por kostot për investime kapitale u mbivlerësuan në vlerë prej 60,261€ për shkak të klasifikimit të dobët të kostove - çështja B2.

menaxhimin e pasurive si më poshtë:

- Komuna ende nuk ka një procedurë të brendshme për administrimin e pasurisë në përputhje me kërkesat e Rregullores së Thesarit 02/2013;
- Nuk është formuar Komisioni i Inventarizimit dhe Vlerësimit të Pronave siç kërkohet me Rregulloren e Menaxhimit të Pronave nr. 02/2013 Nenet 19 dhe 21;
- Nuk ka arritur të regjistrojë asete mbi 1,000€ të blera në vitin 2019 në regjistrin e kontabilitetit (Free Balance). Gjithashtu, nuk është regjistruar pasuria e identifikuar gjatë auditimit për vitin 2018¹¹;
- Pasuritë nën 1,000€ nuk janë regjistruar nga komuna sepse softueri i e-pasurive nuk është në përdorim, ndërsa nuk ka të dhëna për stoqet.

Ndikimi Mungesa e rregulloreve të brendshme, mos azhurnimi i regjistrit të pasurive dhe mos harmonizimi i gjendjes së inventarit me gjendjen e regjistrit kontabël rrit rrezikun që asetet të keqpërdoren, tjetërsohen ose humbasin, dhe vlera e pasurive të organizatës të paraqitura në PVF të mos jetë e saktë.

Rekomandimi B4 Kryetari duhet të sigurojë që forcohen kontrollet në menaxhimin dhe raportimin e pasurisë, në mënyrë që menaxhimi dhe raportimi i pasurisë të kryhet në përputhje me kërkesat ligjore. Për më tepër, duhet të sigurohet që marrëveshjet për bashkëfinansim me ministritë të sqarojnë pronësinë e objekteve të ndërtuara pas përfundimit. Gjithashtu është e nevojshme të rritet bashkëpunimi i Zyrtarit të Pronës me Thesarin në mënyrë që të mundësohet regjistrimi i investimeve të reja në objektet ekzistuese, si dhe vlera e shtuar e objektit bazë.

2.3 Trajtimi i parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të parasë

Avancet e pajustificuara të paraqitura në PVF për vitin 2019 arrijnë në 10,928€, me një shpjegim të 8,500€ petty cash ndërsa 2,428€ është një kartë krediti dhe se këto mjete nuk janë mbyllur për periudhën 2016-2018. Sipas të dhënave të komunës, zyrtari nuk ishte në gjendje të mbyllte avansin sepse nuk kishte asnjë dëshmi për mbyllje.

¹¹ Ambulanca në fshatin Mogila, 45 parcela toke; Objektet e ndërtuara përmes marrëveshjeve të financimit me komunitat janë në vlerë 135,866€

Çështja A3 – Dobësi në menaxhimin e avanceve

Gjetja Komuna nuk ka caktuar një zyrtar për para të imta (petty cash), bazuar në Rregulloren Financiare 01/2010 për Kontrollin e Brendshëm dhe Rregullën Financiare 01/2013 për shpenzimin e parave publike.

Rregulla Financiare 01/2013 për Shpenzimin e Parave Publike, neni 27, parashikon që personeli që udhëton për qëllime zyrtare mund të marrë një paradhënie në para të gatshme ose të përdorë një kartë krediti sipas Udhëzimit Administrativ 04/2009 për kartat e kreditit për udhëtime zyrtare. Për të siguruar mbylljen e Kartës së kreditit, është e nevojshme të paraqiten faturat e duhura në shërbimin financiar. Bashkëngjiten faturat e kartës së kreditit për shpenzimet e bëra.

Kryetari kishte përdorur Kartë krediti për qëndrim jashtë Kosovës gjatë vitit 2019 në vlerë prej 667€. Megjithëse karta kreditit e sistemit në Thesar ishte e mbyllur (barazuar), ne nuk morëm prova (fatura) për kostot e bëra.

Nga rishikimet e avansit në vlerë prej 1,500€, shuma prej 1,041€ ishte shpenzuar për ushqim dhe pije.

Ndikimi Vonesat në mbylljen e avanceve rrisin rrezikun e mos kthimit të mjeteve financiare. Mos arsyetimi i kostove të udhëtimit rrit rrezikun që paratë publike të përdoren në kundërshtim me objektivat dhe rregullat e zbatueshme.

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të sigurojë që avancet të justifikohen brenda një periudhe të caktuar me Rregulloren 2004/07. Formularëve të mbylljes duhet t'i bashkëngjiten të gjitha faturat, kërkesat dhe listat para momentit të mbylljes.

2.4 Të arkëtueshmet

Komuna në PVF –të e 2019 shpalosi të arkëtueshmet në vlerë prej 593,250€, që tregon një prirje të rritjes së këtyre llogarive në krahasim me vitin 2018 kur vlera e arkëtimeve ishte 519,026€. Kjo vlerë përbëhet nga të arkëtueshmet nga tatimi në pronë dhe taksa e biznesit.

Sistemi i regjistrimit të tatimpaguesve është i centralizuar në bazën e të dhënave për tatimin në pronë, që përmban informacione për të gjitha komunat në Kosovë dhe mirëmbahet nga Departamenti i tatimit në pronë në Ministrinë e Financave (MF). Çdo komunë është e detyruar të bëjë verifikimin, d.m.th. të menaxhoj futjen e informatave për tatimin në pronë brenda bazës së të dhënave, me të gjitha informacionet, përfshirë tatimin në pronë, adresat e pronave, adresat e pronarëve dhe përdoruesve, të dhënat për tokën dhe ndërtesat, vlerat e pronave,

normat tatimore, detyrimet tatimore, si dhe regjistrimet e pagesave tatimore, të cilat komuna e Klllokot nuk i ka bërë në afatin e parashikuar me ligj.

Çështja B5 – Dobësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme

Gjetja Edhe pse Komuna ka bërë përpjekje të vazhdueshme për të mbledhur borxhet e tatimit në pronë, të cilat arrijnë në 452,510€ në fund të vitit 2019, sipas Zyrtarit për të Hyrat Komunale, aftësia për të mbledhur tatimin në fund të vitit 2019 ishte 83,989€ ose vetëm 18.6% %, që është një rritje prej 6.6%, krahasuar me vitin 2018, por ende është një nivel i ulët i mbledhjes së tatimit.

Inkasantët e deleguar nga Komuna, të cilët mbledhin tarifat për shërbimet e grumbullimit të mbeturinave, kanë një bazë të përdoruesve që nuk është ende një evidencë e besueshme e të dhënave për pagesa dhe borxhe (të arkëtueshme), për shkak të mos regjistrimit të të gjithë obliguesve në emër të këtij shërbimi. Gjithashtu, të arkëtueshmet në emër të këtij shërbimi nuk janë raportuar në Departamentin e Buxhetit dhe Financave në fund të vitit, si rezultat i të cilave nuk u paraqitën të dhënat në PVF.

Ndikimi Mungesa e inkasantve dhe azhurnimi i parregullt i bazave të të dhënave ka ndikuar, se jo të gjithë obliguesit janë regjistruar në regjistrin e obliguesve, të arkëtueshmet janë duke u rritur nga viti në vit dhe se komuna nuk ka të dhëna për llogarinë e arkëtueshme për shërbimet e grumbullimit të mbeturinave.

Rekomandimi B5 Kryetari duhet të analizojë arsyet e trendit në rritje të llogarive të arkëtueshme të tatimit në pronë dhe të forcojë kontrollet për të parandaluar rritjen e tyre të mëtejshme. Kryetari duhet të krijojë një strategji dhe mekanizma për të mundësuar identifikimin dhe mbledhjen e borxheve të akumuluar, përmes futjes së kushtëzimit të disa shërbimeve komunale bazuar në dëshmitë për pagesën e tatimin në pronë. Gjithashtu, është e nevojshme që Komuna të menaxhojë në mënyrë të duhur llogaritë e arkëtueshme për shërbimet e mbledhjes së mbeturinave.

2.5 Detyrimet e pa paguara dhe kontigjente

Raporti për detyrimet e papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2019 është 69,862€¹². Këto detyrime janë bartur për pagesa në vitin 2020. Ndërsa detyrimet kontigjente janë shpalosur në vlerë prej 95,207€.

¹² Kjo shumë është prezantuar nga komuna, neni 17 raporti për detyrimet e papaguar mbi 30 ditë.

Detyrimet e kontigjente paraqesin detyrimet e mundshme që rrjedhin nga ngjarjet e kaluara dhe ekzistenca e të cilave do të konfirmohet vetëm nga ndodhja ose mos-ndodhja e një ose më shumë ngjarjeve të pasigurta në të ardhmen, të cilat nuk janë plotësisht nën kontrollin e subjektit të audituar ose janë detyrime të tanishme që rrjedhin nga ngjarjet e kaluara, por nuk njihen sepse nuk ka gjasa që të kërkohej një rrjedhje e burimeve për të shlyer detyrimin ose shuma e detyrimit nuk mund të vlerësohet me besueshmëri të mjaftueshme.

Ulja e drejtpërdrejtë e detyrimeve kryhet në bazë të shlyerjes së detyrueshme, marrëveshjeve jashtë gjyqësorë, vendimit gjyqësor të formës së prerë, si dhe në raste të tjera për të cilat ekziston një dokumentacion i besueshëm, kur mund të vlerësohet realisht që detyrimet aktuale nuk do të paguhen brenda 60 ditëve nga dita kur ato duhet të paguheshin.

Çështja A4 – Raportim jo i plotë i detyrimeve të papaguara dhe detyrimeve kontigjente

Gjetja Komuna ka shpalosur shumën e detyrimeve të mundshme kontigjente që lidhen me çështje gjyqësore të ndryshme në vlerë prej 95,207€¹³. Në kuadër të kësaj vlere, është prezantua shuma prej 70,801€, që përfaqëson detyrimin e komunës që janë paraqitur pas përfundimit të proceseve gjyqësore (në marrëveshje me komunën) të përfunduar gjatë vitit 2018. Në emër të këtij detyrimi¹⁴, është paguar shuma totale prej 66,936€, ndërsa për këtë rast vetëm shuma prej 18,964€ është dashur të regjistrohet në kuadër të detyrimeve të pa paguara për vitin 2019. Detyrimet kontigjente janë mbivlerësuar për vlerën, 70,801€.

Gjithashtu, Komuna nuk e paraqiti vlerën e detyrimeve që rrjedhin nga nënshkrimi i shtatë marrëveshjeve për shërbime të veçanta.

Ndikimi Paraqitja e detyrimeve të shlyera në kuadër të detyrimeve kontigjente, si dhe mos prezantimi i detyrimeve që rrjedhin nga angazhimet e kontraktuara, çon në prezantimin e të dhënave të pasakta në PVF.

Rekomandimi A4 Kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme për të siguruar që prezantimi i detyrimeve dhe detyrimeve kontigjente të jetë i saktë.

Çështja B6 - Menaxhimi jo adekuat i faturave të papaguara dhe raportimi i detyrimeve

Gjetja Sipas rregullit financiar nr. 01/2013, nenit 24 Pranimi dhe pagesat e faturës, të gjitha faturat duhet të pranohen /raportohen duke përdorur procedurat e kontrollit të brendshëm për qarkullimin e dokumentacionit. Në këtë aspekt, faturat e pranuar duhet të evidentohen dhe regjistrohen në librin e llogarive / protokolleve. Ne kemi vërejtur që asnjë nga faturat e marra nga OE nuk janë protokoluara dhe nuk kishte datë të pranimit nga

¹³ Shuma e paraqitur nga Komuna në PVF 2019 neni 18,...

¹⁴ Detyrim për qiranë e objektit komunal është parapa prej 70,801€, vendimi prej gjykatës për pages 85,900€ është paguar 66,936€, vlera prej 18,964€ ka qenë dashtë të prezantohet si detyrim i pa paguar.

Komuna, duke rezultuar me një regjistër të pa azhurnuar të faturave të papaguara.

Rregulla financiare nr.02/2013 MF për Raportimin e Detyrimeve të Papaguara të Organizatave Buxhetore detyron të gjitha organizatat buxhetore të raportojnë detyrime të papaguara në Thesar. Komuna nuk raportoi rregullisht në Thesar mbi detyrimet e papaguara në baza mujore, përkatësisht gjatë vitit 2019 ajo raportoi në Thesar gjithsej shtatë herë, përfshirë raportin në fund të vitit. Arsyeja për të mos raportuar rregullisht është neglizhenca e zyrtarit raportues.

Ndikimi Mos protokollimi i faturave rrit rrezikun e humbjes ose dyfishimit të pagesës së të njëjtës faturë dhe mos paraqitjes së gjendjes aktual të detyrimeve të Komunës.

Rekomandimi B6 Kryetari duhet të sigurojë që të gjitha faturat e pranuar të regjistrohen në librin e protokolleve për të përmbushur kërkesën e ligjit për protokollimin e dokumenteve. Gjithashtu, kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme në mënyrë që raportimi i detyrimeve ndaj Thesarit të bëhet në baza mujore.

2.6 Funksioni i auditimit të brendshëm

Nga organizatat buxhetore kërkohet të sigurojnë që aktivitetet dhe proceset e tyre t'i nënshtrohen auditimit të brendshëm. Një sistem i duhur i auditimit të brendshëm ndihmon menaxhmentin të identifikojë dobësitë në menaxhimin financiar dhe kontrollet komunale. Kjo kontribuon në përmirësimin e kontrollit të brendshëm, arritjen e qëllimeve dhe përmirësimin e shërbimeve të ofruara nga komuna.

Çështja B7 – Moszbatimi i funksionit të auditimit të brendshëm

Gjetja Rregullorja e Brendshme Nr. 01/2019 për Themelimin e funksionit të Auditimit të Brendshëm të Sektorit publik, përcakton se nëse komuna nuk ka një buxhet prej 3 milion, duhet të zbatojë dispozitat e nenit 4, paragrafi 1.3 dhe të siguroj shërbime të auditimit të brendshëm për të vlerësuar kontrollin e brendshëm. Me gjithë rekomandimet tona të përsëritura, komuna ende nuk ka qenë në gjendje të sigurojë shërbime të auditimit të brendshëm.

Ndikimi Mungesa e rishikimeve të vazhdueshme të auditimit të brendshëm mund të ndikojë në përsëritjen e vazhdueshme të dobësive në sistemet kryesore të kontrollit të brendshëm. Për më tepër, menaxhmenti mund të mos jetë në gjendje të identifikojë dobësitë e kontrollit në kohën e duhur dhe të

përgjigjet për t'i eliminuar ato.

Rekomandimi B7 Kryetari duhet të sigurojë zbatimin e Rregullores së Brendshme Nr. 01/2019 dhe të sigurojë zbatimin e funksionit të kontrollit të brendshëm përmes një prej mënyrave të parashikuara në nenin 4 të kësaj rregulloreje, sepse funksioni i auditimit të brendshëm shton vlerë në menaxhimin përgjegjës duke siguruar sigurime këshilluese të orientuara drejt rrezikut.

3 Progres në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PVF-të për vitin 2018 rezultoi në 19 rekomandime. Komuna ka përgatitur një Plan veprimi i cili përshkruan qartë se si do të zbatohen rekomandimet e dhëna.

Komuna dorëzoi raporte për progresin në zbatimin e rekomandimeve (13 Mars 2020) në përputhje me kërkesat që rrjedhin nga Rregullorja e Procedurës për zbatimin e auditimeve dhe planeve të veprimit. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2019 janë zbatuar pesë rekomandime, një është në proces, tetë nuk janë adresuar akoma dhe pesë janë mbyllur.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën e zbatimit, shihni Tabelën 4 (ose Tabelën e Rekomandimeve).

Tabela 4. Përmbledhje e rekomandimeve nga viti i kaluar viti 2019

Nr.	Fusha e auditimit	Rekomandimet për vitin 2018	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	PVF	Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për theksimin e çështjes, në këtë raport. Veprime specifike duhet të ndërmerren për t'i forcuar kontrollet për të siguruar se të gjitha shpenzimet klasifikohen drejtë sipas kategorive ekonomike si dhe pasqyrat prezantohen në përputhje me kërkesat e rregullores së MF-së për raportimin vjetor financiar. Po ashtu, kryetari duhet të siguroj se të gjitha pasuritë komunale janë të evidentuara në regjistrat e pasurisë (regjistri kontabël dhe regjistri i pasurisë) dhe shpalosen drejtë në PFV-të e vitit 2019. Më tutje, Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV-ve për vitin 2019 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-ve janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme	Gabime të përsëritura në lidhje me klasifikimin e dobët të shpenzimeve, pagesa bazuar në vendime gjyqësore.	Rekomandim i pazbatuar.
2	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Kryetari duhet të sigurojë që planifikimi dhe buxhetimi i shpenzimeve kryhet në përputhje me natyrën e shpenzimeve dhe se të gjitha transaksionet financiare kryhen në përputhje me dispozitat e LMFPP, në kuadër të buxhetit, në kohë dhe në vendin e saktë. Pagesat që i janë subjekt i vendimeve të gjykatës dhe barazimeve duhet të klasifikohen në mënyrë të drejtë, në mënyrë që paraqitja e tyre në PVF të jetë e saktë. Është i domosdoshëm shqyrtimi kritik i statusit të obligimeve të papaguara, për të përcaktuar prioritetin e pagesave, për të shmangur rrethanat që mund të shkaktojnë pagesën e tyre të drejtpërdrejtë nga Thesari		Rekomandim i pazbatuar.
3	Procesi buxhetor	Kryetari duhet të vazhdojë të sigurojë zbatimin e ligjeve, rregulloreve dhe detyrimeve kontraktuale në mënyrë që komuna të shmangë hyrjen në çfarëdo kontestesh dhe kostosh shtesë të	Nuk ka pasur konteste të reja gjatë vitit 2019 të	Rekomandim i mbyllur.

		procedurave gjyqësore dhe ti zvogëlojë pagesat nga buxheti në bazë të kontesteve gjyqësore.	raportuara nga Komuna.	
4	Të hyrat	Kryetari i Komunës duhet të bëjë një sistematizim adekuat të vendeve të punës duke i mbuluar dhe pozitat e anketuesve, arkëtarit dhe inspektorit të ndërtimit. Gjithashtu, është i domosdoshëm edhe përditësimi i të gjithë bazës ekzistuese të të dhënave të tatimpaguesve nga të cilët arkëtohen pagesat për shërbime komunale, si dhe të fillohet me evidentimin e detajuar dhe me kohë të pagesave dhe me raportimin si për pagesat ashtu edhe për të arkëtueshmet. Shuma e arkëtuara të të ardhurave duhet të depozitohen në bankë, në përputhje me rregullat në fuqi	Janë angazhuar punëtorët në pozitën e arkatarit dhe inspektori i ndërtimit, ndërsa çështja që lidhej me shërbimet komunale u përsërit.	Rekomandim i zbatuar pjesërisht.
5	Paga dhe mëditje	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që punonjësit me kontrata për shërbime të veçanta të angazhohen vetëm kur ka kërkesa të veçanta dhe se për këto shërbime të zbatohen procedura të thjeshtuara të punësimit që nuk do të zgjasin më shumë se gjashtë muaj. Komuna duhet të mbajë tatimin në burim të pagës së punëtorëve të saj, në përputhje me UA Nr.01/2016 Mbi zbatimin e Ligjit 05/L-028 Për të ardhurat personale.	Edhe këtë vit komuna ka të njëjtën situatë.	Rekomandim i pazbatuar.
6	Paga dhe mëditje	Komuna duhet që me një procedurë të përshpejtuar të urdhërojë ndryshimin e koeficienteve të mësimdhënësve të punësuar paga e të cilëve është duke u përlllogaritur me koeficiente të gabuara.	Vetëm shtatë punëtorë kanë ndryshuar koeficientet	Rekomandim i pazbatuar.
7	Paga dhe mëditje	Kryetari duhet të përcaktojë përgjegjësinë e atyre që me veprimet e tyre e kanë sjellë Komunën në këtë pozitë shumë të pafavorshme, dhe të marrë masat e duhura në përputhje me ligjin dhe për të forcuar kontrollin e brendshëm në mënyrë që në të ardhmen, me rastin e largimit të punëtorëve të respektohet Ligji i Punës dhe Udhëzimet Administrative në fuqi.		Rekomandim i zbatuar.

8	Paga dhe mëditje	Kryetari i Komunës të vërtetojë përgjegjësinë individuale të shkëljes së ligjit gjatë zbatimit të procedurave të konkursit, të anulojë emërimin e drejtorëve të shkollave, dhe që sa më shpejt që është e mundur të shpallë konkurse publike në përputhje me Udhëzimin Administrativ të MASHT-it nr.08/2014 për Procedurat dhe kriteret për përzgjedhjen e drejtorëve në institucione arsimore, si dhe të shtojë kontrollin e brendshëm në mënyrë që në të ardhmen, me rastin e pranimeve të reja të respektohen ligji i punës dhe të gjitha udhëzimet administrative në fuqi.		Rekomandim i zbatuar.
9	Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Kryetari duhet të sigurojë respektim adekuat dhe efektiv të politikave /procedurave të prokurimit, si dhe menaxhim të duhur të kontratave për të siguruar vlerën për paratë e shpenzuara për prokurim. Me mbikëqyrjen sistematike e ekzekutimit të kontratës do të rritej siguria për zbatimin e tyre në përputhje me kushtet e kontratës.	E njëjta kontratë kornizë ka përfunduar për shkak të shpenzimit të fondeve.	Rekomandim i mbyllur.
10	Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Kryetari duhet të sigurojë ndërmarrjen e masave dhe procedurave në mënyrë që secili prokurim të kryhet në përputhje me procedurat e përcaktuara në LMFP.	Nuk është identifikua ndonjë rast, ku shpenzim është bërë pa prokurim.	Rekomandim i mbyllur.
11	Subvencionet	Kryetari duhet të sigurojë monitorimin e duhur të shpenzimit të subvencioneve në mënyrë që subvencionet e ndara të arrijnë qëllimin e synuar njësitë kompetente të kërkojnë raporte kthyes.	Subvencionet e trajtuara gjatë këtij auditimit, nuk parashikohet raportimi kthyes.	Rekomandim i mbyllur.

12	Investimet kapitale	Kryetari duhet të marrë masa të cilat mundësojnë që inicimit të procedurave për prokurim i paraprijnë kërkesa e përfunduar e njësisë, i cili kërkon blerjen në bazë të nevojave dhe qëllimeve të organizatës përkatëse.	Nuk janë identifikua raste të ngjashme gjatë auditimit të vitit 2019.	Rekomandim i zbatuar.
13	Investimet kapitale	Kryetari duhet të marrë parasysh arsyet e dështimit të kontrollit me rastin e përgatitjes së tenderëve për kontratat e ndërtimit dhe për të siguruar që projektet e synuara janë të përcaktuara qartë. Gjatë procesit të vlerësimit të ofertave Menaxheri i Prokurimit duhet ti përmbahet LPP dhe udhëzimeve të përdorimit. Kryetari duhet të sigurojë që projektet janë të pajisura me dokumentacionin e nevojshëm në përputhje me kërkesat e ligjit për ndërtim, me që rast fillimisht sigurohet leja e ndërtimit, mbikëqyrja inspektuese gjatë ekzekutimit dhe në fund të projektit të sigurohet lejet e përdorimit. Gjithashtu duhet të monitorohet realizimi i rregullt i kësaj kontrate në të ardhmen në përputhje me çmimet e ofertës financiare.	Nuk janë identifikua raste të ngjashme gjatë auditimit të vitit 2019.	Rekomandim i zbatuar.
14	Çështjet e përbashkëta për mallrat, shërbimet si dhe investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj monitorim adekuat të realizimit të kontratës. Menaxheri i Kontratës duhet të ketë një plan për menaxhimin e kontratës për të përcaktuar nëse ofertuesi i përmbush detyrimet e tij kontraktuale në kohë dhe në një mënyrë që është e përcaktuar me kontratë.	Nuk janë identifikua raste të ngjashme gjatë auditimit të vitit 2019.	Rekomandim i zbatuar.
15	Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që janë forcuar kontrollet në menaxhimin dhe raportimin e pasurive, në mënyrë që menaxhimi dhe raportimi i tyre të bëhet në përputhje me kërkesat ligjore. Për më tepër, duhet të sigurojë që marrëveshjet e bashkëfinancimit me ministritë ta sqarojnë pronësinë e ndërtesave pas përfundimit të tyre. Është gjithashtu e nevojshme që të rritet bashkëpunimi i zyrtarit të pasurisë me Thesarin për të lejuar regjistrimin e investimeve të reja në objektet ekzistuese, si dhe vlerën e shtuar të objektit primar.	Ekzistojnë dobësi në menaxhimin e pasurisë.	Rekomandim i pazbatuar.

16	Të arkëtueshmet	Kryetari duhet ti analizojë arsyet për trendin në rritje të llogarisë së arkëtueshme të tatimit në pronë dhe për të forcuar kontrollin me qëllim të parandalimit të rritjes së tyre të mëtejshme. Duhet të krijojë strategji dhe mekanizma për të lehtësuar identifikimin dhe arkëtimin e borxheve të akumuluar, nëpërmjet futjes së disa shërbimeve komunale të kushtëzimit të bazuar në dëshmi të pagesës së tatimit në pronë. Gjithashtu, është e nevojshme që Komuna të menaxhon në mënyrë adekuate llogaritë e arkëtueshme në emër të shërbimit për e mbledhjes së mbeturinave dhe taksave për veprimtari afariste.	Janë identifikuar parregullsi në menaxhimi në të arkëtueshmeve.	Rekomandim i pazbatuar.
17	Obligimet e papaguara	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që të gjitha faturat e pranuar regjistrohen në librin e protokollit, në mënyrë për të përmbushen detyrimet e ligjit për protokollet. Gjithashtu, Kryetari i Komunës duhet të forcojë kontrollet e brendshme në mënyrë që prezantimi i obligimeve të jetë i saktë.	Janë identifikuar parregullsi në shpalosjen, raportimin, menaxhimi në obligimeve.	Rekomandim i pazbatuar.
18	Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari duhet të shqyrtojë rekrutimin e një auditor të brendshëm, i cili nëpërmjet një programi gjithëpërfshirës të punës do të selektojë rreziqet financiare dhe të tjera të Komunës, dhe i cili do të vlerësonte efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Përveç kësaj ne propozojmë edhe formimin e Komitetit efektiv të Auditimit, i cili do të shqyrtonte në mënyrë kritike planet dhe rezultatet e auditimit të brendshëm.	Nuk ka siguruar shërbim të auditimit të brendshëm.	Rekomandim i pazbatuar.
19	Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut	Kryetari duhet të sigurojë vlerësimin e rrezikut duke identifikuar objektivat kryesore, fushat eventalisht problematike, si dhe masat për të ulur rrezikun në një nivel të pranueshëm. Është i nevojshëm delegimi i përgjegjësisë së drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut tek një nga drejtorët përkatës të cilët në koordinim me drejtuesit e njëjësive do ta menaxhonin këtë proces dhe në baza mujore të raportojnë për menaxhimin e rrezikut.		Rekomandim i mbyllur.

Nr	Fusha e revizionit	Rekomandimet e vitit 2019
1	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që kërkesat të planifikohen dhe kategorizohen sipas ndarjes adekuate të buxhetit. Nëse projeksionet e buxhetuara me ligj të buxhetit nuk përkojnë me natyrën e shpenzimit dhe kërkesat e komunës, duhet të bëhet ridestinimi i mjeteve me qëllim të sigurimit të fondeve për pagesën e rregullt të shpenzimeve. Kjo duhet të reflektoj në përpjekjen për buxhetimin e kërkesave në kategoritë përkatëse ekonomike dhe fuqizimin e kontrollit për pagesën, evidentimin dhe prezantimin e drejt të shpenzimeve publike në PFV.
2	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë që është realizuar planifikimi objektiv për mbledhjen e të hyrave vetjake bazuar në një analizë të mirëfilltë paraprake.
3	Të hyrat	Kryetari duhet të inicojë ri-miratimin e Rregullores për pagesën e shërbimeve në mbledhjen dhe deponimin e mbeturinave, në përputhje me Ligjin Nr. 04 / L-060 për mbeturinat.
4	Të hyrat	Kryetari duhet të analizojë arsyet dhe pengesat për shkak të të cilave nuk janë zbatuar kërkesat ligjore në këtë fushë dhe të ndërmarrë veprime shtesë me qëllim të verifikimit të pronës komunale në vitin e ardhshëm në përputhje me ligjin.
5	Pagat dhe mëditjet	Komuna duhet të urdhërojë ndryshime në koeficientet dhe kontratat për të gjithë punonjësit e departamentit të arsimit në përputhje me normën.
6	Mallrat dhe shërbimet	Kryetari duhet të sigurojë që kërkesat për vende pune të rregullta dhe afatgjate, kur është e nevojshme, adresohen në MF përmes planifikimit adekuat të buxhetit, duke siguruar që angazhimi të bëhet në përputhje me kërkesat ligjore përmes një procesi konkurrues dhe transparent.
7	Pasuria kapitale dhe jo-kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që të forcohen kontrollet në menaxhimin dhe raportimin e pasurisë, në mënyrë që menaxhimi dhe raportimi i pasurisë të kryhet në përputhje me kërkesat ligjore. Për më tepër, duhet të sigurohet që marrëveshjet për bashkëfinansim me ministritë të sqarojnë pronësinë e objekteve të ndërtuara pas përfundimit. Gjithashtu është e nevojshme të rritet bashkëpunimi i Zyrtarit të Pronës me Thesarin në mënyrë që të mundësohet regjistrimi i investimeve të reja në objektet ekzistuese, si dhe vlera e shtuar e objektit bazë.
8	Trajtimi i parasë të gatshme	Kryetari duhet të sigurojë që avanset të justifikohen brenda një periudhe të caktuar me Rregulloren 2004/07. Formularëve të mbylljes duhet t'i bashkëngjiten të gjitha faturat, kërkesat dhe listat para momentit të mbylljes. Nëse ka një kthim të parave nga avnset për udhëtim zyrtarë, shuma e mbetur e pashpenzuar i kthehet llogarisë komerciale.

9	Të arkëtueshmet	Kryetari duhet të analizojë arsyet e trendit në rritje të llogarive të arkëtueshme të tatimit në pronë dhe të forcojë kontrollet për të parandaluar rritjen e tyre të mëtejshme. Ai duhet të krijojë një strategji dhe mekanizma për të mundur identifikimin dhe mbledhjen e borxheve të akumuluar, përmes futjes së kushtëzimit të disa shërbimeve komunale bazuar në provat e taksës së paguar të pronës. Gjithashtu, është e nevojshme që Komuna të menaxhojë në mënyrë të duhur llogaritë e arkëtueshme për shërbimet e mbledhjes së mbeturinave.
10	Detyrime e pa paguara dhe kontigjente	Kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme për të siguruar që prezantimi i detyrimeve dhe detyrimeve të mundshme të jetë i saktë.
11	Detyrime e pa paguara dhe kontigjente	Kryetari duhet të sigurojë që të gjitha faturat e pranuar të regjistrohen në librin e protokolleve për të përmbushur detyrimin e ligjit për protokollin. Gjithashtu, kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme në mënyrë që raportimi i detyrimeve ndaj Thesarit të bëhet në baza mujore.
12	Auditimi i brendshëm	Kryetari duhet të sigurojë zbatimin e Rregullores së Brendshme Nr. 01/2019 dhe të sigurojë zbatimin e funksionit të kontrollit të brendshëm përmes një prej mënyrave të parashikuara në nenin 4 të kësaj rregulloreje, sepse funksioni i auditimit të brendshëm shton vlerë në menaxhimin përgjegjës duke siguruar siguri këshilluese të orientuara drejt rrezikut.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pamodifikuar** nëse arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse Pasqyrat Financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në Pasqyrat Financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale, por nuk janë përhapur në Pasqyrat Financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë materiale, por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në Pasqyrat Financiare.

155. Auditori duhet të japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë, edhe materiale, edhe të përhapura. Nëse, pas pranimi të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi Pasqyrat Financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit


157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë Pasqyrat Financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhen t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të Pasqyrave Financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letër konfirmimi



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Komuna e Klokot / Opština Klokot / Municipality of Klokot

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2019 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së **Klokotit**, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.


Z. Bozidar Dejanovic.
 Kryetar i Komunës së Klokotit

Data: 29.07.2020, Klokot,